

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

21 MARS 2024

Sigurisht, nuk mund të mos e përshëndes kthimin e normalitetit në parlament, por, në fakt, do të duhet të jetë një parlament me normalitet real. Anormaliteti po vazhdon sot, ku e gjithë salla hesht, hesht për një ngjarje që do të duhet të ndodhte sot, më 21 mars, në ditën e fundit të Komisionit të Reformës Zgjedhore. Nuk e shoh këtu, madje, as zotin Gjikhuri. Pra, duket fare qartë se cili është pakti dhe marrëveshja: të heshtim!

Zonja Kryetare, e kërkova fjalën për procedurë, sepse sot është dita e fundit e Komisionit të Reformës Zgjedhore dhe ky parlament e ka për detyrë të deklarojë, edhe dështimin, po të doni ju, të Komisionit të Reformës Zgjedhore, ku detyrën kryesore e keni ju për ta nxjerrë sot në rendin e ditës produktin e tij, që është projektligji i depozituar nga ana e Partisë Demokratike këtu e pesë muaj më parë, më 15 nëntor të vitit të kaluar. Ky është normalitet! Ky është sinqeritet!

Ne e kemi depozituar variantin tonë të reformës zgjedhore: lista të hapura, Shqipëria - një zonë, votim/numërim elektronik, si dhe vota e diasporës, që ose bëhet sot, ose nesër është vonë.

Ndaj kërkesa ime për procedurë, për ju, për të gjithë këtë parlament, është që sot të marrin pak kurajë e të votojnë, edhe kundër. E rëndësishme është t'u flasin shqiptarëve ashtu siç duhet.

Ta pranojnë, pra, që nuk i duan listat e hapura, që nuk duan të përballen me qytetarët, që kanë frikë nga qytetarët! Ta pranojnë që duan ta përjashtojnë diasporën nga vota, gjysmën e shqiptarëve ta përjashtojnë, e le ta thonë sot me votë!

Ta pranojnë pra, që t'i dhurojmë Edi Ramës 6 mandate në tavolinë me këtë sistem, e t'i dhurosh edhe një mandat tjetër në vitin 2025. Ta pranojnë pra, pikërisht këtë gjë dhe të dalim pastaj përballë qytetarëve shqiptarë dhe medias, kudo. Kjo është një çështje procedure, që do të duhet të ndodhë tani, nuk mund të heshtim. Heshtja nuk është gjë tjetër veçse pakt, është marrëveshje, është pazar në kurriz të shqiptarëve për të mbrojtur karriget, për të mbrojtur listat e mbyllura, për të mbrojtur politikën e vjetër 34- vjeçare, që bajlozët e politikës të rrinë këtu të mbrojtur, sepse kanë një frikë, frikë nga drejtësia. Ky nuk mund të jetë një parlament i frikës. Deputetë që kanë frikë të përballen me qytetarët. Po, kanë frikë nga drejtësia, por shtoi edhe frikën nga qytetarët. Ndaj t'i hapim letrat, të jemi të sinqertë, ta tregojmë sa kurajozë jemi! Kështu do të na gjykojnë shqiptarët.

Prandaj, zonja Kryetare, tani në fund po e bëj edhe kërkesën: njofto që është depozituar projektligji nga Partia Demokratike dhe të futet në procedurë për votën e diasporës, për listat e hapura, për Shqipërinë një zonë, për votim dhe numërim elektronik dhe lërua pastaj njerëzve t'i gjykojnë.

Faleminderit!